



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02-29057/20
Kaçanik, 17.11.2020

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, Rregullores 01 Nr. 07-60/01-17890/19 për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Kaçanikut, Shpalljes Publike 07 Nr. 104/02-27091/20 e dt. 26.10.2020 dhe pas propozimit të drejtorit të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, kryetari i komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit të përkohshëm

- I. Me këtë vendim formohet komisioni i përkohshëm, i cili ka për qëllim të bëjë vlerësimin e operatorëve ekonomik privat për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në zonën e III-të (sipas Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave).
- II. Komisioni komunal ka për detyrë të shqyrtoj kërkesat e operatorëve ekonomik privat duke u bazuar në Shpalljen Publike 07 Nr. 104/02-27091/20 të dt. 26. 10. 2020 për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në zonën e III-të.
- III. Komisioni komunal për shqyrtimin, verifikimin dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik komunal, do të jetë me këtë përbërje:
 1. Menduh Krasniqi - shef i sektorit të shërbimeve publike;
 2. Eljesa Begunca - zyrtare për hapësira publike dhe
 3. Arditë Shehu - zyrtare për mbrojtjen e mjedisit;
- IV. Komisioni obligohet që menjëherë të filloj punën dhe me raport me shkrim për punën e vet të njoftoj zyrën e kryetarit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
- VI. Me këtë vendim, njoftohen: Anëtarët e Komisionit dhe Arkivi.

Besim Ilazi
Kryetar i Komunës